

	POLITIKA E CILËSISË	PO-SIM-001
	<i>ver. 5.0</i>	<i>faqe 1 nga 1</i>
<i>Menaxhimi Cilësisë dhe Politikave</i>		

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d

POLITIKA E CILËSISË

Nr. 879 Dt. 06-05-2021
 PRISHTINË-A

KOSTT sh.a, është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, një subjekt i cili luan rol të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë.

Si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST), KOSTT-i është përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë si dhe është përgjegjës për transmisionin e energjisë elektrike të tensionit të lartë.

Si Operator i Tregut të energjisë elektrike, KOSTT-i është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë si dhe për menaxhimin e procesit të vendimmarrjes përfundimtare.

Qëllimet tona janë: ofrimi i shërbimeve cilësore që i përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe rregullatore, punonjësve, shoqërisë si dhe sigurimi i një gjendje të qëndrueshme financiare. Implementimi i standardit të menaxhimit të cilësisë do të jetë mbështetje e fortë për arritjen e këtyre qëllimeve.

Për të arritur këto qëllime menaxhmenti dhe punonjësit e KOSTT janë të përkushtuar që në vazhdimësi të sigurohet:

- Përmbushja e kërkesave ligjore dhe rregullative;
- Përmbushja e kërkesave për integritet në Institucione Evropiane të Sektorit të Energjisë;
- Veprimi sipas përgjegjësisë të ndara, autoriteteve dhe procedurave të përcaktuara;
- Përmbushja e kërkesave që dalin nga standardi;
- Përmirësimi efektiv dhe i vazhdueshëm i proceseve të punës;
- Ndërveprim-ndërlidhje e mirë e të gjitha proceseve në KOSTT;
- Ngritja e vazhdueshëm e aftësive dhe shkathtësive të personelit;
- Veprimi preventiv me qëllim të evitimit të jokonformiteteve;
- Njohja dhe zbatimi në përpikëri i standardeve të implementuara në KOSTT;
- Njohja, zbatimi dhe rishikimi i Politikës së Cilësisë në harmoni me zhvillimin e Biznesit të KOSTT;

Obligimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përvojë dhe motivim të punonjësve tanë, ngritjen e aftësive të tyre gjithashtu edhe përcjelljes së zhvillimit teknologjik dhe kërkesave të tregut.

Datë: 06.05.2021

Kryeshefi Ekzekutiv
 Mustafë Hasani, PhD

